



**COVID-19
VACCINE**
Public Health
Advice



Vaksina Comirnaty (Pfizer/
BioNTech) për fëmijët dhe
të rinjtë e moshës 12 deri
në 15 vjeç

Informacione të rëndësishme
për prindërit dhe kujdestarët

Versioni 12
14 shtator 2023



Rialtas na hÉireann
Government of Ireland

Rreth kësaj broshure

Kjo broshurë ju informon rreth vaksinës së COVID-19 (koronavirusit) për fëmijët e moshës 12 deri në 15 vjeç.

Informacionet që gjeni këtu janë:

- COVID-19 tek fëmijët e moshës 12 deri 15 vjeç
- çfarë është vakcina e COVID-19
- përparësitë e vaksinimit për fëmijët e moshës 12 deri 15 vjeç
- rreziqet e vaksinimit për fëmijët e moshës 12 deri 15 vjeç
- siguria e vaksinës dhe efektet anësore
- çfarë të prisni pasi të kenë bërë vaksinën e COVID-19
- dhënia e miratimit për vaksinimin e tyre kundër COVID-19
- ku mund të merrni më shumë informacion

Ju lutemi ta lexoni këtë broshurë me kujdes. Përmes kësaj broshure duam t'ju japim mundësinë të merrni një vendim pasi të jeni informuar rreth vaksinimit për fëmijën tuaj. Mund të flisni rreth vaksinës edhe me një specialist të kujdesit shëndetësor, si mjeku juaj i familjes (doktori) ose një farmacist.

Ju mund:

- të lexoni broshurën e informimit të pacientit nga prodhuesi, që e gjeni në **www.hse.ie/covid19vaccinePIL**
- të diskutoni rreth vaksinimit me fëmijën tuaj ose të lexoni broshurën së bashku me ta
- të lexoni informacionet e tjera që i gjeni në **www.hse.ie**

Rreth COVID-19

COVID-19 është një sëmundje që mund të prekë mushkëritë dhe rrugët e frymëmarrjes e ka raste edhe pjesë të tjera të trupit. Ai shkaktohet nga një virus që quhet koronavirus.

Është shumë ngjitës. Ai përhapet nga ajri përmes spërklave që lëshojnë njerëzit kur kolliten apo teshtijnë, ose kur prekin sipërfaqet ku kanë rënë spërklat, e më pas prekin sytë, hundën ose gojën.

Simptomat më të zakonshme të COVID-19 përfshijnë:

- ethe (temperaturë e lartë 38 gradë Celsius e lart) - duke përfshirë ethet
- kollë e thatë
- lodhje

Simptomat mund të shfaqen deri në 14 ditë pas ekspozimit ndaj COVID-19. Simptomat mund të jenë të ngjashme me ato të ftohjes ose të gripit. Fëmija juaj mund të mos i ketë të gjitha këto simptoma ose mund të mos ndihen mirë si zakonisht.

Nëse fëmija juaj ka ndonjë nga simptomat e COVID-19, ata duhet të vetizolohen (të qëndrojnë në dhomën e tyre) dhe duhet të vizitosh **www.hse.ie/covid19** për këshilla.

COVID-19 dhe fëmijët e moshës 12 deri 15 vjeç

Pjesa më e madhe e fëmijëve dhe të rinjve të moshës 12 deri në 15 vjeç që infektohen me COVID-19 kanë simptoma shumë të lehta ose asnjë simptomë. Infektimi me COVID-19 në këtë moshë mund të jetë diçka e bezdisur, sepse fëmijëve u duhet të mungojnë në shkollë.

COVID-19 mund të shkaktojë sëmundje serioze, shtrim ose vdekje tek fëmijët, por në raste shumë të rralla.

Ndonjëherë simptomat që lidhen me COVID-19 mund të vazhdojnë për disa javë ose muaj ('COVID i zgjatur'). Rreziku i kësaj gjendjeje shëndetësore është më i ulët tek fëmijët dhe adoleshentët, në krahasim me të rriturit.

Rreziku i shtrimit në spital të një fëmije për shkak të COVID-19 është i ulët dhe rreziku i nevojës së një fëmije për trajtimin në reanimacion është jashtëzakonisht i ulët.

Fëmijët dhe të rinjtë me probleme të caktuara shëndetësore janë më të rrezikuar për t'u sëmurur rëndë. Sipas të dhënave nga Shtetet e Bashkuara, rezulton se 7 në 10 fëmijë të shtruar në spital me COVID-19 kanë sëmundje bashkëshoqëruese.

Në raste të rralla, COVID-19 mund të shkaktojë atë që quhet Sindroma Inflammatorë Multisistemike tek fëmijët (MIS-C). 75% e fëmijëve që zhvillojnë MIS-C nuk kanë asnjë sëmundje kronike.

Kjo sindromë shkakton pneumoni, inflamacion të zembrës dhe vështirësi në frymëmarrje. Shumica e fëmijëve me MIS-C shërohen pas disa kohësh në spital ose në reanimacion, por ka fëmijë që kanë efekte anësore afatgjata dhe një pjesë e vogël mund të vdesë. MIS-C shihet më rrallë pas infektimit me omicron.

Çfarë është vakcina COVID-19?

Vaksina është një substancë që duhet të përmirësojë imunitetin (mbrojtjen) nga një sëmundje e veçantë. Vaksinat e mësojnë sistemin imunitar të njeriut se si të mbrohet nga sëmundjet.

Faktet e disponueshme thonë se vakcina e COVID-19 duhet t'i ofrojë fëmijës suaj mbrojtje nga rastet e rënda të infektimit me COVID-19. Nëse fëmijët vaksinohen, do të reduktohet gjithashtu edhe numri i personave që mund të sëmuren rëndë apo edhe të vdesin nga COVID-19 në komunitetin tonë.

Çfarë vaksine do t'i ofrohet fëmijës tim?

Vaksina që do t'i ofrohet fëmijës suaj quhet Comirnaty (Pfizer/BioNTech).

Kjo është një vaksinë mRNA që e mëson trupin e fëmijës suaj të prodhojë një proteinë që do të nxisë reagimin imunitar të organizmit, pa e përdorur virusin e gjallë që shkakton COVID-19.

Më pas, trupi i fëmijës suaj do të prodhojë antitrupa për luftimin e infeksionit, nëse virusi COVID-19 hyn në trupin e tyre në të ardhmen.

Përpara vaksinimit, do t'ju kërkohet të jepni pëlqimin për vaksinimin e fëmijës suaj dhe ky pëlqim do të regjistrohet.

Vaksinat Comirnaty që i ofrohen fëmijës suaj janë vakcina të përshtatura. Vaksinat e përshtatura përmbajnë mRNA për të mbrojtur kundër varianteve të llojeve të COVID-19. Këto pritet të japin mbrojtje më të gjerë kundër varianteve të COVID-19 sesa vakcina origjinale.

Vaksinat e përshtatura rekomandohen për fëmijët e moshës 12-15 vjeç nga Komiteti Këshillues Kombëtar i Imunizimit dhe janë miratuar nga Agjencia Evropiane e Barnave.

Përse u ofrohet vakcina gjithë fëmijëve të moshës së 12 deri 15 vjeç?

Duke ofruar vaksinën për popullatën, synojmë të mbrojmë njerëzit dhe të zvogëlojmë rastet e sëmundjeve dhe të vdekjeve të shkaktuara nga ky virus.

Vakcina e COVID-19 duhet ta mbrojë fëmijën tuaj dhe ata përreth nga sëmurja e rëndë me COVID-19. Edhe pse rastet e rënda me COVID-19 janë të rralla në këtë grupmoshë, rreziku i sëmurjes rëndë me COVID-19 është edhe më i ulët nëse janë të vaksinuar.

Vaksinat e COVID-19 rekomandohen shumë nga Komiteti Këshillues Kombëtar i Imunizimit (NIAC) për fëmijët që kanë sistem imunitar të dobët.

Për gjithë fëmijët e kësaj grupmoshe, NIAC rekomandon që përparësitë e vaksinimit janë më të mëdha se rreziqet nga vakcina.

Përparësitë përfshijnë ndihmën në shmangien e infektimit me COVID-19 dhe më shumë mbrojtje nga rreziku i rrallë i rasteve të rënda të COVID-19. Fëmijët që janë të vaksinuar kanë më pak mundësi të mungojnë në shkollë dhe në aktivitete të tjera për shkak të COVID-19.

Përse u ofrohet një dozë përforcuese e parë të gjithë fëmijëve të moshës së 12-15 vjeç?

Mbrojtja që fëmija juaj ka nga vaksinat e mëparshme mund të dobësohet me kalimin e kohës.

Mbrojtja e zvogëluar, së bashku me variantin Omicron me transmetueshmëri të lartë, do të thotë që më shumë fëmijëve të moshës 12 deri 15 vjeç i është nevojitur kujdes spitalor në valën më të fundit të pandemisë, sesa në valët e tjera.

Shpresojmë që një dozë e parë përforcuese të japë mbrojtje më të mirë kundër COVID-19 dhe të reduktojë rastet e sëmundjes dhe nevojën për kujdes spitalor tek fëmijët e kësaj grupmoshe.

Për fëmijët me sistem imunitar të dobët rekomandohet një dozë përforcuese e parë.

Megjithatë, të gjithë fëmijët e moshës 12-15 mund të bëjnë një dozë përforcuese, sepse:

- Përfitimet e vaksinës janë më të mëdha se rreziqet
- Redukton rreziqet dhe komplikimet e COVID-19 (duke përfshirë sëmurjen e rëndë, COVID-in e zgjatur dhe MIS-C)
- Kanë më pak shanse të mungojnë në shkollë dhe në aktivitete të tjera të rëndësishme për mirëqenien e tyre
- Mund të ofrojnë mbrojtje më të mirë ndaj varianteve të ardhshme

Përse disa fëmijëve me sistem të dobët imunitar u ofrohet një dozë shtesë?

Nëse fëmija juaj është 12 vjeç e lart dhe ka pasur një sistem imunitar të dobët kur ka kryer raundin e parë të vaksinave kundër COVID-19, ai mund të kërkojë një dozë shtesë.

Shpresojmë që një dozë e dytë e vaksinës:

- do të përmirësojë reagimin e sistemit të tyre imunitar ndaj vaksinës
- u jep atyre mbrojtje më të mirë ndaj COVID-19
- i ndalon që të sëmuren nga rastet e rënda me COVID-19

Pse u ofrohen dozat përforcuese në vjeshtë disa fëmijëve të moshës 12-15 vjeç me sistem imunitar të dobët?

Një dozë përforcuese në vjeshtë rekomandohet për fëmijët e moshës 12-15 vjeç që kanë një sistem imunitar të dobët.

Kjo për shkak se mbrojtja nga vaksinat që kanë bërë më parë mund të dobësohet me kalimin e kohës, që do të thotë:

- ata mund të jenë në rrezik më të lartë për sëmundje të rëndë
- sistemi imunitar i tyre nuk reagon fort ndaj vaksinimit

Përditësimi me dozat përforcuese i jep fëmijës suaj mbrojtje shtesë nga COVID-19 dhe ndihmon në parandalimin e sëmundjeve të rënda nga COVID-19.

Pse disa fëmijëve me kushte mjekësore u ofrohet një dozë përforcuese në vjeshtë?

Një dozë përforcuese në vjeshtë rekomandohet për fëmijët e moshës 12-15 vjeç që kanë një gjendje shëndetësore që i rrezikon shumë ata të sëmuren rëndë nëse infektohen me COVID-19.

Kjo për shkak se:

- mbrojtja që fëmija ka marrë nga vaksinat e mëparshme ose mbrojtja që fëmija ka marrë nga infektimi me COVID-19 mund të dobësohet me kalimin e kohës
- fëmija juaj mund të jetë në rrezik më të lartë të sëmundjes së rëndë nëse infektohet me COVID-19

Dozat përforcuese rrisin mbrojtjen e fëmijës nga COVID-19. Pa ato, fëmijët janë më të rrezikuar të sëmuren rëndë nëse infektohen me COVID-19.

A është efektive vakcina për fëmijët e moshës 12 deri 15 vjeç?

Provata klinike për vaksinën Comirnaty (Pfizer/BioNTech) kanë treguar se ka qenë tepër efektive në parandalimin e infektimit të fëmijëve të kësaj moshe me COVID-19.

A është e sigurt vakcina për fëmijët e moshës 12 deri 15 vjeç?

Kjo vaksinë e COVID-19 rekomandohet nga NIAC për fëmijë të moshës 12 vjeç e lart në Irlandë.

Si pjesë e provave klinike, kjo vaksinë është testuar në mijëra njerëz, duke përfshirë mbi 2000 fëmijë e të rinj të moshës 12 deri në 15 vjeç. Në provat klinike nuk janë identifikuar shqetësime sigurie shtesë për fëmijët dhe të rinjtë e moshës 12 deri 15 vjeç.

Pritet që siguria e vaksinave të përshtatura të jetë e ngjashme me vaksinat e mëparshme. Siguria e vaksinave do të vazhdojë të monitorohet nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA)

Kjo vaksinë përmbush gjithashtu standardet e sigurisë, cilësisë dhe efektivitetit dhe është miratuar e licencuar nga organet rregullatore. Në Irlandë, organi rregullator është Agjencia Evropiane e Medikamenteve (EMA) – vizitoni www.ema.europa.eu për më shumë informacion.

Për t'u miratuar për përdorim, vakcina i ka kaluar të gjitha provat klinike dhe kontrollet e sigurisë të cilave u nënshtrohen gjithë medikamentet e tjera të licencuara, duke ndjekur standardet ndërkombëtare të sigurisë. Monitorimi i sigurisë së gjithë vaksinave të COVID-19 shqyrtohet në vazhdimësi nga autoritetet përkatëse.

Ndërkohë që puna për zhvillimin e vaksinave të COVID-19 ka ecur shumë më shpejt se zakonisht, vakcina që po i ofrojmë fëmijës suaj i ka kaluar të gjitha fazat e zakonshme që nevojiten për zhvillimin dhe miratimin e një vaksine të sigurt dhe efektive.

Jemi ende duke mësuar rreth efektivitetit dhe efekteve anësore të vaksinave të COVID-19 në këtë grupmoshë.

Të gjitha medikamentet kanë efekte anësore, ndaj duhet të lexoni në këtë fletëpalosje për efektet e zakonshme dhe ato të rralla anësore që njihen deri më sot për këtë vaksinë, para se të jepni miratimin për vaksinimin e fëmijës suaj.

Vaksinat për COVID-19 u janë bërë miliona fëmijëve në shumë vende.

Çfarë dini rreth sigurisë dhe efekteve anësore të dozave përforcuese apo dozave shtesë të vaksinës tek fëmijët e moshës 12 - 15 vjeç?

Një sërë vendesh po bëjnë doza përforcuese dhe doza shtesë në këtë grupmoshë.

Ka më pak informacion të disponueshëm lidhur me sigurinë e dozës përforcuese dhe dozave shtesë.

Miokarditi dhe perikarditi janë sëmundje inflamatore të zemrës dhe janë rreziqe shumë të rralla për vaksinat e tipit mRNA. Këto efekte anësore të rralla janë më të zakonshme te meshkujt nën 30 vjeç, pas dozës së dytë të ciklit të parë të vaksinës. Rreziku i këtyre efekteve anësore duket se është më i ulët pas dozës së parë përforcuese. Rreziku i miokarditit mund të jetë më i ulët te personat e moshës 12-15 vjeç krahasuar me adoleshentët më të rritur.

Pritet që siguria e vaksinave të përshtatura të jetë e ngjashme me vaksinat e mëparshme. Siguria e vaksinave do të vazhdojë të monitorohet nga EMA.

Fëmija im e ka kaluar COVID-19, a mund ta bëjë vaksinën?

Nëse fëmija juaj ka kaluar COVID-19, me shumë gjasë kanë krijuar një farë imuniteti. Pra, edhe nëse fëmija juaj e ka kaluar COVID-19, mund të infektohet sërish.

Vaksina zvogëlon rrezikun e riinfektimit me COVID-19.

A mund ta bëjë vaksinën e COVID-19 fëmija im nëse ka temperaturë të lartë?

Jo. Nëse ka temperaturë (38 gradë Celsius e lart) duhet ta shtyni bërjen e vaksinës, derisa fëmija të ndihet më mirë.

A mund ta infektojë vaksina me COVID-19 fëmijën tim?

Jo. Vaksina e COVID-19 nuk mund ta infektojë fëmijën tuaj me COVID-19. Mund të ndodhë që të jetë infektuar me COVID-19 përpara se të bëjë vaksinën dhe të mos e kuptojë se ka simptoma deri në momentin e vaksinimit.

Nëse fëmija juaj ka ndonjë nga simptomat e COVID-19 - ose ka temperaturë që fillon më shumë se 2 ditë pas vaksinës, ose zgjat më shumë se 2 ditë - ai duhet të vetizohet (të qëndrojë në shtëpi) dhe ju duhet të vizitoni faqen www.hse.ie/covid19 për këshilla.

A mund ta bëjë fëmija ime vaksinën e njëkohësisht me vaksina të tjera?

Si masë paraprake, nëse fëmija juaj ka marrë së fundmi vaksinën MPOX (e njohur më parë si lija e majmunit) (Imvanex ose Jynneos), ai duhet të presë 4 javë përpara se të marrë vaksinën e COVID-19, për shkak të rrezikut të panjohur të miokarditit.

Megjithatë, fëmija juaj mund ta marrë një vaksinë kundër COVID-19 në të njëjtën kohë me çdo vaksinë tjetër që i nevojitet, duke përfshirë vaksinën e tij kundër gripit me sprej nga hunda dhe çdo vaksinim në shkollë.

Kush është vaksinuesi i fëmijës tim?

Është personi që i bën fëmijës vaksinën. Ata janë trajnuar nga HSE për administrimin e vaksinave të COVID-19.

Si bëhet vaksina e COVID-19?

Vaksina e COVID-19 bëhet si injeksion në pjesën e sipërme të krahut. Zgjat vetëm pak minuta.

Sa doza të vaksinës së COVID-19 duhet të bëjë fëmija im?

Për raundin e tij të parë të vaksinave kundër COVID-19, të gjithë fëmijët kanë nevojë për 2 doza të kësaj vaccine, me 8 javë diferencë, për mbrojtje nga sëmundjet e rënda.

Fëmijët e moshës 12 deri në 15 vjeç mund të marrin një dozë të parë përforcuese të paktën 4 muaj pas raundit të parë të vaksinës ose infektimit me COVID-19.

Nëse fëmija juaj ka një gjendje mjekësore që e vë në rrezik më të lartë për t'u sëmurur rëndë me COVID-19, atij i rekomandohet një dozë përforcuese në vjeshtë, e cila duhet të jepet 9 muaj pas vaksinës ose infektimit të fundit me COVID-19.

Megjithatë, nëse fëmija juaj ka një sistem imunitar të dobët, ai duhet ta marrë dozën e dytë 4 javë pas dozës së parë. Atij mund t'i nevojitet një dozë shtesë e vaksinës COVID-19 8 javë pas dozës së dytë. Kjo më pas ndiqet nga një dozë e parë përforcuese 4 muaj pas dozës shtesë ose pas infektimit me COVID-19.

Për fëmijët me sistem imunitar të dobët të cilët kanë marrë një dozë shtesë dhe një dozë të parë përforcuese rekomandohet një dozë përforcuese në vjeshtë. Dozat përforcuese të vjeshtës duhet të jepen 6 muaj pas një doze përforcuese të mëparshme ose pas infektimit me COVID-19.

Fëmija im është aktualisht me COVID-19, a mund ta bëjë vaksinën?

Nëse fëmija juaj ka COVID-19 dhe ai duhet të marrë dozën e parë të vaksinës, ai mund të vaksinohet 4 javë nga shfaqja për herë të parë e simptomave ose nga testi pozitiv i COVID-19.

Nëse fëmija juaj ka COVID-19 dhe ai duhet të marrë dozën e dytë të vaksinës, ai mund të vaksinohet 8 javë nga shfaqja për herë të parë e simptomave ose nga testi pozitiv i COVID-19.

Nëse fëmija juaj me sistem imunitar të dobët ka kaluar COVID-19 pas dozës së dytë dhe duhet të marrë dozën shtesë:

- nëse infektimi i tij me COVID-19 ka qenë më shumë se 7 ditë pas dozës së dytë të vaksinës, nuk nevojitet një dozë shtesë. Ai duhet të vazhdojë të marrë dozën e tij të parë përforcuese 4 muaj pas infektimit
- nëse fëmija juaj infektohet me COVID-19 brenda 7 ditëve nga doza e dytë, ai duhet të marrë dozën e tij shtesë 4-8 javë pas infektimit

Nëse fëmija juaj duhet të marrë një dozë përforcuese, ju lutemi lexoni pyetjen e mëparshme për informacion se kur fëmija juaj mund të marrë një dozë përforcuese pas një infektimi me COVID-19.

A është licencuar nga EMA ose NIAC doza shtesë apo doza përforcuese e vaksinës?

Dozat shtesë për disa fëmijë që kanë një sistem imunitar të dobët:

- EMA ka miratuar një dozë shtesë të së njëjtës vaksinë mRNA, të paktën 28 ditë pas dozës së dytë.
- NIAC, në Irlandë, ka rekomanduar që ata të mund të marrin vaksinën Pfizer si një dozë shtesë 8 javë pas dozës së dytë.

Dozat e para përforcuese për të gjithë fëmijët në këtë grupmoshë:

- EMA ka miratuar një dozë të parë përforcuese të vaksinës Pfizer për fëmijët në këtë grupmoshë që më parë kanë marrë Pfizer, të paktën 3 muaj pas dozës së fundit.
- NIAC, në Irlandë, ka rekomanduar që fëmijët e kësaj grupmoshe të mund të marrin vaksinën Pfizer si dozë përforcuese, pavarësisht nga vakcina mRNA që kanë marrë më parë, 4 muaj pas dozës së tyre të fundit për COVID-19.

Dozat përforcuese vijuese për disa fëmijë në këtë grupmoshë:

- NIAC ka rekomanduar një dozë përforcuese në vjeshtë për fëmijët e moshës 12-15 vjeç me një gjendje shëndetësore që i vendos ata në rrezik të lartë të sëmundjes së rëndë nëse infektohen me COVID-19. NIAC ka rekomanduar një dozë përforcuese në vjeshtë për disa fëmijë me sistem imunitar të dobët.

A ndjekim këshillat e EMA apo të NIAC në Irlandë?

- Rekomandimet e NIAC-ut mund të jenë të ndryshme nga ato të EMA-s për shkak të të dhënave dhe konsideratave vendase.

Në Irlandë ne ndjekim këshillën e NIAC.

Cila janë efektet anësore të vaksinës?

Si të gjitha medikamentet, edhe vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore. Shumica e tyre janë të lehta deri mesatare, afatshkurtra dhe nuk shfaqen tek të gjithë.

Më shumë se 1 në 10 persona do të kenë këto efekt anësore **shumë të zakonshme**:

- ndjesinë e lodhjes
- ndjeshmëri ose ënjtje të krahut në vendin e injeksionit të vaksinës
- dhimbje koke
- dhimbje muskujsh
- dhimbje kyçesh
- diarre
- temperaturë (38 gradë Celsius e lart) ose ethe

Deri në 1 në 10 persona do të kenë këto efekte anësore **të zakonshme**:

- marrje mendsh
- të vjella
- skuqje në vendin ku është bërë vaksina
- ënjtje të gjëndrave limfatike (vërehet më shpesh pas një doze përforcuese)

Deri në 1 në 100 persona do të kenë këto efekte anësore **të pazakonta**:

- marramendje
- kruarje në vendin ku është bërë vaksina
- kruarje të përgjithshme
- acarim të lëkurës
- pagjumësi
- djersitje e shtuar
- djersitje gjatë natës
- rënie oreksi
- mungesë energjie, plogështi ose gjendje jo të mirë
- dhimbje te krahu ku keni bërë vaksinën

Deri në 1 në 1000 persona do të kenë këto efekte anësore **të rralla**:

- varje e përkohshme në njëën anë të fytyrës

Deri në 1 në 10 000 persona do të kenë këto efekte anësore **shumë të rralla**:

- miokardit dhe perikardit – do të thotë inflamacion të muskullit të zemrës ose membranës së muskullit të zemrës (shihni më poshtë për simptomat.)

Miokarditi dhe perikarditi janë inflamacione të zemrës. Rreziku i këtyre problemeve është më i lartë tek djemtë e rinj.

Këto probleme kanë më shumë gjasë të ndodhin pas dozës së dytë dhe ndodhin kryesisht 14 ditë pas bërjes së vaksinës.

Dy studime evropiane kanë përlllogaritur rrezikun e miokarditit, pas dozës së dytë të vaksinës, si:

- 1 rast më shumë për çdo 38 000 meshkuj të moshës 12 deri në 29 vjeç (brenda 7 ditësh)
- 1 rast më shumë për çdo 17 500 meshkuj të moshës 16 deri në 24 vjeç (brenda 28 ditësh)

Të dhëna të hershme nga vende të tjera tregojnë se miokarditi ka më pak gjasë të shfaqet tek personat e moshës 12 deri 15 vjeç në krahasim me ata 16 deri 24 vjeç. Të dhënat e hershme për persona të moshës 16 vjeç e lart tregojnë se miokarditi raportohet më rrallë pas dozës përforcuese sesa dozës së dytë. Të dhënat sugjerojnë se shumica e rasteve të miokarditit zgjasin vetëm pak dhe përmirësohen me kujdes shëndetësor; me studimet përkatëse për të kuptuar ndikimin afatgjatë.

Ende nuk dihet se sa persona që bëjnë vaksinën do t'i provojnë këto efekte anësore, por mendohet se janë **jashtëzakonisht të rralla**:

- një reaksion alergjik i rëndë. Vaksinuesi juaj është trajnuar të trajtojë reaksionet e rënda alergjike.
- Eritema Multiforme, një reaksion lëkure që shkakton pika ose njolla të kuqe që mund të duken si një “objektiv” ose “shënjestër” me një qendër të kuqe të errët, të rrethuar nga unaza të kuqe më të çelëta
- ënjtje e fytyrës nëse keni mbushës (filler) facialë
- ënjtje e konsiderueshme e krahut (ose këmbës) ku është bërë vakcina
- ndjesi dridhjesh ose shpimi, ose humbje e ndjesisë në disa pjesë të trupit
- perioda të rënda

Vakcina e COVID-19 i është nënshtruar të njëjtave prova klinike dhe kontrolleve të sigurisë si gjithë vaksinat e tjera të licencuara, megjithatë vakcina është e re dhe informacionet për efektet anësore afatgjata janë të kufizuara.

Sa më shumë persona ta bëjnë këtë vaksinë në Irlandë dhe nëpër botë, aq më shumë informacione do të kemi për efektet e saj anësore. HSE do ta përditësojë këtë informacion rregullisht në faqen tonë të internetit, dhe nëse nevojitet, do të përditësojë broshurat informuese që u jepen njerëzve në momentin e vaksinimit.

Simptomat e miokarditit dhe perikarditit

Shumë rrallë, mund të ndodhë që të shkaktohet miokardit dhe perikardit pas bërjes së vaksinës së Comirnaty (Pfizer/BioNTech). Miokarditi dhe perikarditi janë inflamacione të zemrës.

Duhet të keni parasysh shenjat që duhet pasur kujdes tek fëmija juaj.

Kërkoni ndihmë mjekësore nëse fëmija juaj ka një nga këto simptoma pas bërjes së vaksinës:

- mosmbushje me frymë
- palpitacione (rrahje të forta të zemrës që mund të jenë të çrregullta)
- dhimbje gjoksi

A ka fëmijë që nuk duhet ta bëjnë vaksinën e COVID-19?

Po. Fëmija juaj nuk duhet ta bëjë vaksinën e COVID-19, Comirnaty (Pfizer/BioNTech), nëse:

- Ka pasur një reaktion të rëndë alergjik ndaj një prej përbërësve të vaksinës (duke përfshirë polietilen glikolin ose PEG). Lexoni broshurën e informimit të pacientit nga prodhuesi, për të parë listën e përbërësve
- Ka pasur një reaktion të rëndë alergjik me dozën e parë të vaksinës së COVID-19 të Pfizer/BioNTech ose të Moderna
- Ka pasur një reaktion të rëndë alergjik nga Trometamoli (një nga përbërësit në lëndën e kontrastit që përdoret në studimet radiologjike MRI).
- Është këshilluar nga doktori që të mos bëjë vaksinën e COVID-19 të Moderna ose vaksinën e COVID-19 të Pfizer/BioNTech

Duhet të flisni me mjekun e fëmijës para se t'i bëni fëmijës vaksinën e COVID-19, nëse:

- Ka pasur një reaktion të rëndë alergjik (anafilaksi) në të shkuarën, duke përfshirë edhe nga vaksina apo mjekime të tjera
- ka pasur miokardit ose perikardit (inflamacion i muskujve të zemrës ose cipës mbështjellëse të zemrës) pas një doze të mëparshme të vaksinave kundër COVID-19

Si masë paraprake, nëse fëmija juaj ka marrë së fundmi vaksinën MPOX (Imvanex ose Jynneos), ai duhet të presë 4 javë përpara se të marrë vaksinën e COVID-19, për shkak të rrezikut të panjohur të miokarditit.

Shumica e fëmijëve mund ta bëjnë vaksinën në mënyrë të sigurt. Personi që do t'i bëjë vaksinën fëmijës suaj do t'i përgjigjet me kënaqësi pyetjeve që do të keni në momentin e vaksinimit.

Do t'ju japë gjithashtu një broshurë me këshilla për kujdesin e mëtejshëm, si dhe një kartelë vaksinimi ku shkruhet emri dhe numri i partisë së vaksinës që ka bërë fëmija juaj.

Pas bërjes së vaksinës

Sot do t'ju japim një kartelë për vaksinimin e fëmijës suaj. **Ju lutemi ta ruani kartelën në mënyrë të sigurt.**

Çfarë mund të ndodhë gjatë ditëve në vazhdim?

Disa nga personat që kanë bërë vaksinën që ka bërë fëmija juaj sot, mund të kenë disa nga efektet anësore të renditura në këtë broshurë. Shumica e tyre janë të lehta deri mesatare dhe zgjasin pak.

Temperaturë pas bërjes së vaksinës

Është shumë e zakonshme të ketë rritje të temperaturës pas bërjes së vaksinës. Zakonisht, kjo ndodh brenda 2 ditësh pas bërjes së vaksinës dhe kalon pas 2 ditësh. Fëmija juaj ka më shumë gjasë t'i rritet temperatura pas dozës së dytë të vaksinës.

Nëse fëmija nuk ndihet mirë, duhet t'i jepni paracetamol ose ibuprofen, sipas udhëzimeve në kutinë apo fletëpalosjen përkatëse. Nëse jeni të shqetësuar për fëmijën tuaj, kërkoni këshillim me mjekun.

Sa kohë duhet që vaksina të ketë efekt?

Pas bërjes së dy dozave të vaksinës së COVID-19, shumica e njerëzve krijojnë imunitet. Kjo do të thotë se do të jenë të mbrojtur nga rastet e rënda me COVID-19.

Pas bërjes së dozës së dytë të vaksinës, duhen 7 ditë që ajo të ketë efekt.

Ekziston ende mundësia që fëmija juaj të infektohet me COVID-19, edhe nëse e ka bërë vaksinën.

A funksionon vaksina tek kushdo?

Vaksinat janë përdorur në miliarda njerëz nëpër botë gjatë vitit të kaluar. Ka prova të forta dhe të besueshme që vaksinat e COVID-19 e reduktojnë ndjeshëm rrezikun e infektimit me COVID-19. Ato janë shumë efektive për parandalimin e vdekjeve dhe sëmurjes së rëndë me COVID-19.

Vaksinat nuk funksionojnë njësoj tek çdo person, prandaj është e mundur të ketë një riiinfektim me COVID-19 edhe pas bërjes së vaksinës.

Nëse fëmija juaj ka një sistem imunitar të dobët, nuk ka asnjë rrezik shtesë nëse bëni vaksinë, por ajo mund të mos funksionojë edhe aq mirë për fëmijën tuaj, dhe atij mund t'i duhet një dozë shtesë e vaksinës së COVID-19 për mbrojtjen më të mirë.

Sa kohë zgjat imuniteti nga vaksina?

Dozat përforcuese rekomandohen për të zgjeruar mbrojtjen e vaksinave të COVID-19. Nuk e dimë akoma se sa do të zgjasë imuniteti pas dozave përforcuese. Provat klinike po vazhdojnë për të arritur në këtë konkluzion.

Kur fëmija im të bëjë vaksinën, a do të thotë se nuk do ta përhapë COVID-19 tek të tjerët?

Nuk e dimë akoma nëse bërja e vaksinës e shmang përhapjen e virusit të COVID-19 tek të tjerët. Prandaj është e rëndësishme që të gjithë bashkë të vazhdojmë të ndjekin këshillat e shëndetit publik për mënyrat e ndalimit të përhapjes së virusit.

Pas vaksinimit, fëmija juaj do të këshillohet të vazhdojë të ndjekë udhëzimet e shëndetit publik për personat e vaksinuar.

Si t'i raportoj efektet anësore?

Sikurse të gjitha vaksinat, efektet e dyshuara anësore mund t'i raportoni pranë Autoritetit Rregullator të Produkteve Shëndetësore (HPRA).

HPRA është autoriteti rregullator në Republikën e Irlandës për medikamentet, pajisjet mjekësore dhe produktet e tjera shëndetësore. Si pjesë e rolit të saj në monitorimin e sigurisë së medikamenteve, HPRA përdor një sistem përmes së cilit specialistët e kujdesit shëndetësor ose pjesëtarë të publikut mund të raportojnë çdo reaksion të dyshuar (efekt anësor) që lidhet me medikamentet dhe vaksinat në Irlandë.

HPRA inkurajon fuqishëm raportimin e reaksioneve të dyshuara negative (efektet anësore) që lidhen me vaksinat e COVID-19 për të mbështetur monitorimin e vazhdueshëm të përdorimit të tyre të sigurt dhe efikas. Për të raportuar një reaksion të dyshuar negativ nga vakina e COVID-19, ju lutemi të vizitoni **www.hpra.ie/report**

Mund t'i kërkonti gjithashtu doktorit tuaj ose një pjesëtar të familjes që të raportojë për ju. Duhet të jepen sa më shumë informacione të njohura, dhe kur është e mundur, duhet të përfshihet edhe numri i partisë së vaksinës.

HPRA nuk mund të ofrojë këshilla klinike për raste individuale. Pjesëtarët e publikut duhet të kontaktojnë specialistin e tyre të kujdesit shëndetësor (doktorit apo farmacistit të tyre) për çdo paqartësi mjekësore që mund të kenë.

Miratimi për vaksinimin e fëmijës suaj

Prindit ose kujdestarit ligjor do t'i kërkohet të japë miratimin për vaksinimin e secilit fëmijë.

Fëmija nuk do të lejohet të hyjë në qendrën e vaksinimit nëse është i pashoqëruar.

Vendimi juaj për të dhënë ose jo pëlqimin për vaksinën do të respektohet. Tabela e mëposhtme përmbledhëse mund të jetë e dobishme për t'ju ndihmuar të informoheni për zgjedhjet tuaja.

Përfitimet e vaksinës	Rreziqet e vaksinës
<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja për fëmijët dhe të rinjtë që kanë probleme shëndetësore që i rrezikojnë ata të sëmurën rëndë me COVID-19. Të dhënat në Shtetet e Bashkuara tregojnë se rreth 7 në 10 fëmijë të shtruar në spital me COVID-19 kanë probleme të tjera shëndetësore. Mbrojtje për fëmijët dhe të rinjtë e shëndetshëm nga rastet e rënda me COVID-19, edhe pse kjo ndodh shumë rrallë në këtë grupmoshë. Rreziku i shtrimit në spital të një fëmije për shkak të COVID-19 është i ulët dhe rreziku i nevojës së një fëmije për trajtimin në reanimacion është jashtëzakonisht i ulët. Mbrojtja nga COVID-19 dhe komplikacionet nga COVID-19 si 'COVID i zgjatur' dhe Sindroma Inflamatorë Multisistemike tek fëmijët. Rreziku për "COVID të zgjatur" është më i ulët tek fëmijët dhe adoleshentët, në krahasim me të rriturit. Mbrojtje nga COVID-19 që mund të shkaktojë mungesën e fëmijëve në shkollë. Mund të ndihmojë në parandalimin e përhapjes së COVID-19 tek të tjerët. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse fëmijët dhe të rinjtë jetojnë me një fëmijë ose një të rritur që rrezikon të sëmurën rëndë me COVID-19. 	<ul style="list-style-type: none"> Efekte afatshkurtra anësore si dhimbje krahu, temperaturë ose lodhje. Rreth 1 në 100 000 persona mund të kenë një efekt anësor të rëndë, si reaksion alergjik ndaj vaksinës. Shumë rrallë, disa njerëz mund të pësojnë inflamacion të zemrës (miokardit) dhe membranës së jashtme të zemrës (perikardit) pas vaksinimit. Shumica e njerëzve shërohen nga miokarditi dhe perikarditi, por mund të kenë nevojë për trajtim spitalor. Nuk kemi ende informacione rreth efekteve afatgjata të vaksinave të COVID-19 tek fëmijët dhe të rinjtë. Kemi më pak informacion lidhur me sigurinë e dozës përforcuese dhe dozave shtesë në moshat 12-15.

Konsideroni ta vaksinoni fëmijën tuaj nëse:	Mos konsideroni ta vaksinoni fëmijën tuaj, ose prisni derisa të ketë më shumë informacione, nëse:
<ul style="list-style-type: none"> Fëmija juaj ka një sëmundje bashkëshoqëruese që e rrezikon atë të sëmurën rëndë me COVID-19. Fëmija juaj jeton me një fëmijë ose një të rritur që rrezikon të sëmurën rëndë me COVID-19. Doni ta mbron fëmijën tuaj nga mundësia shumë e rrallë e sëmurjes rëndë me COVID-19, sindromës inflamatorë multisistemike ose 'COVID i zgjatur'. 	<ul style="list-style-type: none"> Nuk doni të rrezikoni efektin anësor shumë të rrallë të miokarditit dhe perikarditit nga vaksinimi. Doni të prisni për më shumë informacion rreth rrezikut të sindromës inflamatorë multisistemike dhe sëmurjes së fëmijëve dhe të rinjve me COVID-19. Doni të prisni për më shumë informacion rreth rrezikut të efekteve anësore afatgjata të vaksinave tek fëmijët dhe të rinjtë.

Informacione të tjera

Për më shumë informacion, lexoni broshurën informuese të pacientit nga prodhuesi. Ajo do të printohet e do t'ju jepet ditën e vaksinimit të fëmijës suaj, ose mund ta gjeni në faqen www.hse.ie/covid19vaccinePIL

Mund të flisni rreth vaksinës edhe me një specialist të shëndetit, si mjeku juaj i familjes (doktori) ose një farmacist.

Mund të vizitoni gjithashtu faqen e internetit të HSE-së në www.hse.ie/covid19vaccine ose t'i telefononi HSELive në numrin **1800 700 700**.

Për më shumë informacion rreth vaksinës së COVID-19, materiale të tjera në formate të tjera dhe mbështetje me përkthime, vizitoni www.hse.ie/covid19vaccinematerials

Informacioni juaj personal

Për të administruar vaksinën në mënyrë të sigurt dhe për të regjistruar gjithë informacionet e nevojshme për monitorimin dhe menaxhimin e vaksinës, HSE do të përpunojë informacionin personal të fëmijës suaj. Të gjitha informacionet e përpunuara nga HSE do të jenë në përputhje me ligjet e përgjithshme dhe veçanërisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) që ka hyrë në fuqi në vitin 2018.

Përpunimi i të dhënave të fëmijës suaj do të jetë i ligjshëm dhe i drejtë. Ato do të përpunohen vetëm për qëllimin specifik të menaxhimit të vaksinimeve. Është aplikuar parimi i minimizimit të të dhënave. Kjo do të thotë se regjistrohen vetëm të dhënat e nevojshme për identifikimin e fëmijës suaj, prenotimin e takimit, regjistrimin e vaksinimit dhe monitorimin e efekteve përkatëse.

Ju keni të drejtat e mëposhtme në kuadër të GDPR-së për të dhënat personale të fëmijës suaj që janë përpunuar.

- Të kërkonti informacion për të dhënat personale të fëmijës suaj dhe të keni qasje në to (që njihet si 'kërkesë për qasje nga subjekti i të dhënave'). Kjo ju mundëson (si prind ose kujdestar ligjor i fëmijës) të merrni një kopje të të dhënave personale që mbajmë për fëmijën tuaj dhe të kontrolloni nëse po i përpunojmë në mënyrë të ligjshme.
- Të kërkonti korrigjimin e të dhënave personale që mbajmë për fëmijën tuaj. Kjo ju mundëson korrigjimin e çdo informacioni të paplotë ose të pasaktë që mbajmë për fëmijën tuaj.
- Të kërkonti fshirjen e të dhënave personale të fëmijës suaj. Kjo ju mundëson të kërkonti fshirjen heqjen e të dhënave personale të fëmijës suaj, nëse nuk ka më asnjë arsye që të vazhdojmë t'i përpunojmë. Keni gjithashtu të drejtën të na kërkonti të fshijmë ose të heqim të dhënat personale të fëmijës suaj në rastet kur keni ushtruar të drejtën e kundërshtimit të përpunimit të tyre.
- Kundërshtimi i përpunimit të të dhënave tuaja personale.

Për më shumë informacione, vizitoni www.hse.ie/eng/gdpr



**COVID-19
VACCINE**
Public Health
Advice

Publikuar nga HSE më 14 shtator 2023
Për informacionet më të përditësuara,
vizitoni www.hse.ie



Rialtas na hÉireann
Government of Ireland